



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEKANATI

Nr. 250 Prot.

Tiranë më, 14.09. 2023

N J O F T I M

Thirrje për staf akademik me kohë të pjesshme

Viti akademik 2023-2024

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimit të Rektoratit të UPT Nr. 116, datë 22.09. “Për procedurën e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT”, pas plotësimit detyrimit të ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe orëve suplementare në auditor nga departamentet e FIMIF, **Dekani i FIMIF shpall thirrjen për personel akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për vitin akademik 2023-2024.**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesë me shkrim
2. Jetëshkrim (CV)
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore.
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, nëse ka.
7. Rekomandime.

Kandidatët e angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme në FIMIF, më shumë se dy vite rradhazi do të dorëzojnë vetëm një kërkesë.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **25.09.2023** pranë Departamenteve përkatëse, dokumentacionin e sipërcituar.

DEKANATI



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

Tiranë, më 12/09/2023

Lënda: Propozim për kriteret e pranimit të Personelit Akademik me kohë të Pjesëshme pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike për vitin akademik 2023-2024

Drejtuar: Dekanatit të FIMIF

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Ligj nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 62, si dhe në Vendimin e Rektoratit të UPT-së, Nr. 116, datë 22. 09. 2020 “Për miratimin e procedurës së punësimit të Personelit Akademik të Ftuar”, propozojmë kriteret për pranimin e Personelit Akademik me kohë të Pjesëshme pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike, për vitin akademik 2023-2024, si më poshtë:

Kandidati duhet:

1. Të zotërojë Diplomë Universitare (Diplomë e Integruar / Master i Shkencave (3+2)) në Matematikë ose Inxhinieri Matematike;
2. Të kenë notë mesatare të paktën 8 (tetë) (për ciklin e studimit (3+2), nota mesatare për të dy ciklet e studimit);
3. Të ketë përvojë akademike dhe mësimdhënieje;
4. Të ketë kulturë komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup;
5. Të mos ketë penalitete në lidhje me figurën e tij si mësimdhënës;

Bëhet përjashtim për pikën 1 dhe 2 në raste tepër të vecanta kur kërkohen pedagogë në lëndë me kërkesa specifike.

Preferohen kandidatët që kanë gradën “Doktor” apo Tituj Akademike.

Drejtuesi i Departamentit

Prof. Dr. Luela Prifti



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË FIZIKE

Tiranë, më 13/09/2023

Lënda: Propozim për kriteret e punësimit të stafit akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Inxhinierisë Fizike për vitin akademik 2023-2024.

Dekanit të FIMIF

Bazuar në Vendimin e Rektorit Nr. 116, datë 22. 09. 2020 “Për miratimin e procedurës për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT”, Departamenti i Inxhinierise Fizike i propozon Dekanit të Fakultetit, kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes së stafit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024:

1. Të zotërojë Diplomë Universitare (Diplomë e Integruar / Master i Shkencave (3+2)) në Fizikë ose Inxhinieri Fizike;
2. Të kenë notë mesatare të paktën 8 (tetë) (për secilin nga ciklet e studimit);
3. Të ketë përvojë akademike dhe mësimdhënieje. Preferohen kandidatë që janë aktivizuar pranë DIF;
4. Të ketë kulturë komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup;
5. Të mos ketë penalitete në lidhje me figurën e tij si mësimdhënës.

Bëhet përjashtim për pikën 1 dhe 2 në raste tepër të veçanta kur kërkohen pedagogë në lëndë me kërkesa specifike.

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT


Altin Gjevori



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

**FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I KIMISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 11.09.2023

Lënda: Kriteret specifike për personelin akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Kimisë, për vitin akademik 2023-2024

DEKANATIT TË FIMIF

K Ë T U

Për realizimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2023-2024, Departamenti i Kimisë kërkon të aktivizojë tre pedagogë të ftuar, për zhvillimin e lëndës “Kimi e Përgjithshme”. Krahas kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në “Procedurën e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT”, të miratuar me Vendimin nr.116, datë 22.09.2020, të Rektorit të UPT, Departamenti i Kimisë përcaktoi kriteret specifike, si më poshtë:

Kandidati që kërkon të punësohet si personel akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Kimisë duhet, gjithashtu,:

- Të ketë mbaruar studimet e plota universitare (diplomë e integruar ose ciklet 3+2) në degët Kimi Industriale ose Kimi e Përgjithshme
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 8, ndërsa nota mesatare e lëndëve të kimisë të jetë mbi 8.5.
- Preferohet të ketë të paktën 2 vjet përvojë në mësimdhënie dhe në punën në laborator.
- Preferohen kandidatët që kanë tituj dhe grada shkencore

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

Prof. Asoc. Edlira Baraj



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 14/09/2023

Lënda: *Propozim për kriteret e pranimit për personel akademik me kohë të pjesshme në Qendrën e Gjuhëve të Huaja për vitin akademik 2023-2024*

Drejtuar: Dekanatit
Këtu

Duke marrë parasysh nevojat e Qendrës së Gjuhëve të Huaja për personel akademik me kohë të pjesshme, ju propozojmë të nisni procedurat për rekrutimine tyre për vitin akademik 2023-2024:

Qendra e Gjuhëve të Huaja propozon këto kriteret për kandidatët:

1. Të kenë mbaruar studimet në një program studimi në fushën e gjuhës angleze, (sistemi i vjetër ose i ri 3+2)
2. Të kenë mesataren e dy cikleve të studimit apo me program të vjetër studimi me notë mesatare të paktën 8.00
3. Të kenë përvojë akademike dhe mësimdhënieje
4. Preferohen kandidatët që kanë gradën “Doktor” apo tituj akademikë
5. Të ketë kulturë komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup
6. Të mos ketë penaltete në lidhje me figurën e tij si mësimdhënës

Përgjegjësi i Qendrës së Gjuhëve të Huaja

Prof.Dr. Fatmir VRAPI